



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	18.09.2023	24.09.2023	2023/0693

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.09.2023, OE “DataProgNet SH.P.K.”- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me numër 2023/0693, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik të Gjendjes Civile” me numër të prokurimit: "214-23-2530-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 350,000.00 euro.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga autoriteti kontraktues

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPPsë.

- Neni 1 Qëllimi,
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

AK përmes vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit përkundër që jemi rekomanduar

për kontratë dhe nuk ka pasur asnjë ankesë në procedurë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke na diskriminuar si OE, për çka në vijim po i paraqesim faktet dhe argumentet për Ekspertin shqyrtues dhe Panelin Shqyrtues të OSHPsë:

Në njoftimin për vendimin e AK-së të datës 30.06.2023, ne jemi rekomanduar për kontratë nga AK si ofertues i vetëm i përgjegjshëm në raport me kriteret dhe kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës është 05.07.2023

Me datë 08.08.2023 AK përmes sistemit elektronik (eProkurimi) ka kërkuar vazhdimin e zgjatjes së validitetit të tenderit për 60 ditë kalendarike. Po në të njëjtën datë ne kemi zgjatur validitetin e ofertës për 60 ditë kalendarike.

Çuditërisht me datë 28.08.2023 AK ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me këtë aktivitet me arsyetimin si vijon: *"Arsye e anulimit te procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave te paragrafit 2 te nenin 26 te Ligjit te Prokurimit Publik"*. Arsyetimi i dhënë në AK është i pabazë, për faktin se neni 26, konkretisht paragrafi 2 rregullon përgjegjësitë e personave përgjegjës në raport me nënshkrimin e kontratave si veprime obliguese.

Me datë 29.08.2023 përmes sistemi eProkurimi kemi bërë kërkesë tek AK për qasje në dokumentacion, për të u njoftuar për arsyen e mos nënshkrimit të kontratës dhe anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Po në këtë datë na është lejuar qasja dhe jemi njoftuar nga u.d. Drejtori i Prokurimit të MPB-së me arsyeja e anulimit të kësaj procedure, të cilat arsye sipas LPP-ë nuk qëndrojnë.

Me datë 31.08.2023 përmes sistemi eProkurimi kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me datë 06.09.2023 nga AK kemi pranuar vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim me arsyen e njëjta si në vendimin për anulim, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave te paragrafit 2 te nenin 26 te Ligjit te Prokurimit Publik, duke i quajtur pretendimet tona në Kërkesën për rishqyrtim të pa bazuara. Po e potencojmë përsëri se Arsyetimi i dhënë nga AK është i pabazë, për faktin se neni 26, konkretisht paragrafi 2 rregullon përgjegjësitë e personave përgjegjës në raport me nënshkrimin e kontratave si veprime obliguese", në këtë fazë të prokurimit nuk ka kuptim të aplikohet, është krejtësisht i pabazuar dhe AK nuk ka pasur të drejtë fare me u thirr në këtë fazë të prokurimit në nenin 26 paragrafi 2.

Andaj po e ritheksojmë se sipas Ligjit për Prokurimin Publik arsyet për përfundimin e një aktiviteti të prokurimit janë rrethanat e përcaktuara në nenin 62, e në këtë rast asnjëri nga kriteret e këtij neni nuk janë përmbushur duke qenë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm me çmimin e ofruar në kuadër të paramasës buxhetore dhe nuk ka asnjë arsye ligjore për përfundimin e aktivitetit të prokurimit.

Duke e ditur rëndësinë që ka ky sistem për qytetarët Republikës së Kosovës, i klasifikuar si një ndër sistemet më të ndjeshme dhe të rëndësishme softuerike në kuadër të vendit me interes nacional, edhe pse nuk kemi pasur kontratë nga data 05.05.2023, deri në datën e dorëzimit të ankesë në OSHP me 13.09.2023 të gjitha kërkesat që na kanë arritur nga Zyrtarët e MPB-së për dhënie të përkrahjes për Sistemin Elektronik të Gjendjes Civile ju kemi përgjigjur dhe i kemi kryer në kohë, pasi që kemi të qartë rëndësinë e këtij sistemi për MPB-në dhe qytetarët e Republikës së Kosovës (në këtë mënyrë kemi vepruar çdo herë kur MPB nuk ka arritur të lidhë në kohë kontratën, nuk e kemi lënë asnjëherë pa përkrahje dhe nuk kemi kërkuar kompensime financiare shtesë gjatë periudhave kur nuk kemi pasur kontratë).

Gjithashtu ju njoftojmë se "Sistemin Elektronik të Gjendjes Civile" e ka zhvilluar dhe mirëmbajtur kompania DataProgNet SH.P.K.. Gjatë periudhës së zhvillimit, avancimit dhe mirëmbajtjes, nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga institucionet e IRK-së dhe as nga qytetarët, ku ju kemi përkushtuar në maksimum dhe seriozitet të lartë profesional. Nga MPB pas përfundimi të çdo periudhe të mirëmbajtjes 36 mujore posedojmë Referencë POZITIVE.

Stafi i kompanisë DataProgNet SH.P.K. ka punuar me përkushtim dhe seriozitet maksimal në zhvillimin, avancimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi kompleks, që lidhë (furnizon me të dhëna) mbi 100 sisteme tjera shtetërore, të gjitha këto lidhje/komunikime janë realizuar nga ne, ku asnjëherë nuk ka ndodhur që të mos realizohet ndonjë ndërlidhje me sistemet tjera duke dërguar çdo herë të dhëna me saktësi.

Sistemit Elektronik të Gjendjes Civile që është zhvilluar dhe implementuar nga DataProgNet SH.P.K., ka rezultuar me sukses në plotësimin e njërit nga kriteret e kërkesave të liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, duke u bazuar nga faktet dhe argumentet e lartpërmendura, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të marrë vendim merititor, të anulojë vendimin e AK-së të datës 28.08.2023 dhe të detyrojë AK-në që të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës në lidhje me këtë procedurë, meqë është konstatuar së jemi ofertuesi i vetëm i përgjegjshme me çmimin më të lirë

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"DataProgNet" SH.P.K.**

Sqarim hyrës

Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 31.08.2023. AK me 05.09.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor

OE ankues pretendon se AK pas njoftimit për dhënie të kontratës ka nxjerrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Rrethanat e çështjes

- AK ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 22.03.2023 në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.
- Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave, gjithsej tre ofertues kanë dorëzuar tenderë.

- Më tej sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 15.06.2023 i vetmi ofertues i përgjegjshëm është OE ankues (DataProgNet), i cili është rekomanduar për kontratë.
- Meqë në procedurë nuk kishte ankesa, me datë 30.06.2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku sipas njoftimit OE "DataProgNet" i është dhënë kontrata dhe data e planifikuar për nënshkrimin e kontratës ishte 05.07.2023.
- AK me datë 08.08.2023 ka kërkuar nga OE ankues vazhdimin e zgjatjes së validitetit të tenderit për 60 ditë kalendarike. Po në të njëjtën ditë OE ankues ka bërë zgjatjen e validitetit të ofertës për 60 ditë kalendarike.
- AK me datë 28.08.2023 ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me këtë aktivitet me arsyetimin si vijon: *"Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik"*.
- OE ankues me datë 31.08.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së. AK me datë 05.09.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke e lënë në fuqi vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.
- AK, konform nenit 9 të LPP-së ka përgatitur Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve (DNPDP), e cila është nënshkruar me datë 08.03.2023 nga njësisë kërkuese dhe Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA). Ndërsa me datë 15.03.2023 është nënshkruar edhe nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF). Në DNPDP, AK ka paraqitur deklaratën se si ky prokurim do të promovojë objektivat institucionale të AK-së: *"Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik të Gjendjes Civile do të ngritë cilësinë e shërbimeve dhe zgjerimin e këtyre shërbimeve për qytetarët. Përmes këtij sistemi elektronik do të digjitalizohen të gjitha shërbimet të ofruara rreth gjendjes civile."* Informatat në DNPDP para publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së janë rikonfirmuar nga ZKA, ZKF dhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP), ku të tre e kanë nënshkruar me datë 14.06.2023.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Eksperti sqaron se përfundimi i një aktiviteti të prokurimit mund të bëhet vetëm në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së. Bazuar në dëshmitë në procedurë, përkatësisht dokumentet e ngarkuara në eprokurim nuk ka evidencë që një shkelje ka ndodhë që mund të shpie në anulimin e aktivitetit në këtë fazë. Fillimisht, eksperti sqaron se për këtë

aktivitet vlerësimi i nevojave arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit sipas nënshkrimit dhe rikonfirmimit nga ZKA. Më tej, ZKF ka siguruar dhe konfirmuar se ka mjete financiare në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit. Poashtu, sipas vendimeve të nxjerra nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në këtë aktiviteti OE ankues është ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe janë plotësuar të gjitha kushtet për nënshkrimin e kontratës ashtu sikurse është vendosur në njoftimin për dhënie të kontratës në të cilin është përcaktuar edhe data e nënshkrimit të kontratës. Si përfundim, nenit të cilit i është referuar AK (neni 26 - Nënshkrimi i kontratave) sqaron autorizimet e personave përgjegjës për nënshkrimin e kontratës. Çfarëdo arsye brenda AK-së që lidhet me mospërmblidhjen e autorizimeve sipas nenit përkatës nuk mund të cilësohet si shkelje apo ngjarje që nuk mund të rregullohet apo të parandalohet ashtu sikurse përcaktohet në nenin 62 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së, si dhe nuk përfshihet në asnjë nga kushtet e nenit 43.5 të Rregullorës për Prokurimin Publik. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme pretendimi ankimor është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe rekomandon që AK të vazhdojë me tutje me aktivitetin sipas dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"DataProgNet" SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Gjendjes Civile"** me numër të prokurimit: **"214-23-2530-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"DataProgNet" SH.P.K.**

Kreshnik Spaniu

